

FJALA E DEPUTETES PETRIT VASILI

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Askush nuk ka pasur iluzionin më të vogël se do të dëgjonte një program konkret, një program që hap perspektivë dhe kjo do të ndodhte pas 2 mandateve, të cilat kanë qenë njëri më fatkeq se tjetri. Të gjithë e kanë shumë të qartë se i gjithë ky thes demagogjik dhe propagandistik ka pasur dhe ka një qëllim të vetëm: të legjitimojë dhe të çojë drejt përfundimit kapjen e plotë të shtetit dhe shembjen e republikës sonë, pasi fakti më dramatik, ai që ka vënë në diskutim të ardhmen e këtij vendi, është saktësisht kapja e shtetit, kapja e drejtësisë, kapja e zgjedhjeve dhe kapja e ekonomisë. Këto tri shtylla garantojnë tregun e lirë dhe konkurrencën e ndershme, si dhe garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, garantojnë një gjyqësor të pakapur, garantojnë pikërisht atë rend shoqëror për të cilin shqiptarët u ngritën në vitin '90 dhe donin ta ndërtonin, por që sot është shumë herë më i rrezikuar se sa në vitin '90. Për të qenë konkretë dhe shumë të saktë në të gjitha konstatimet, pra për të mos bërë konstatime teorike, le të marrim vetëm çfarë ka ndodhur me reformën në drejtësi, ku hetimi dhe nxjerrja e përgjegjësive dhe përgjegjësve lidhur me bllokimin e reformës është dhe mbetet një nga detyrat më kryesore të opozitës. Gjithashtu, edhe hetimi i të gjitha ndërhyrjeve të njëanshme të kryera nga parlamenti njëpartiak në ligjet e reformës. Në kundërshtim të plotë me Kushtetutën dhe rekomandimet e Venecias, është një atentat tjetër i bërë kësaj reforme. Një proces i tillë shumë i thellë, shumë i përgjegjshëm dhe pa asnjë kompromis, që ndëshkon përgjegjësit rilindës të kapjes së reformës në drejtësi, mund të krijonte edhe mundësitë për një debat lidhur me këtë reformë, e kundërta, moskryerja e një procesi të tillë do të ishte vetëm një shërbim që do t'i bëhej "Rilindjes" për legjitimitetin e kapjes totale të drejtësisë në çdo segment të saj.

*Që të jemi më konkretë, pasi në programin e qeverisë reforma në drejtësi konsiderohet si pronë e qeverisë, si atribut i saj, kur në të vërtetë nuk është kështu, reforma në drejtësi kishte një thelb krejtësisht tjetër: të krijonte pavarësi të sistemit gjyqësor dhe t'i mbante larg duart e qeverisë, të çdo qeverie dhe të çdo maxhorance nga ai. Por çfarë ka prodhuar kjo demagogji kaq e madhe me reformën në drejtësi për qytetarin e thjeshtë dhe në tërësinë e vet? T'i marrim me radhë. Së pari, meqenëse kemi hyrë në vitin e 6-të të reformës, cili është volumi i punës së një gjyqtari? Nga 200 çështje, dosjet janë shtuar, janë bërë 2 mijë dhe është rritur mesatarisht koha nga 180 ditë në 730 ditë. Pra, nga 180 ditë në gati 2 vjet. Ky është produkti i parë, atë që prek qytetari me dorë. Së dyti, dihet më së miri se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi u bllokua shumë gjatë për shkak të dhunimit të Kushtetutës dhe të ligjit nga "Rilindja" pikërisht për ta mbajtur të bllokuar dhe për të shkuar deri te zgjedhjet që e kapnin reformën. Së treti, janë shkelur që të gjitha afatet kushtetuese të reformës në drejtësi të votuara më 21-22 korrik dhe nuk ka dalë asnjë përgjegjësi konkrete, duke u shndërruar kështu Kushtetuta dhe ndryshimet konsensuale të 21-22 korrikut në ndryshime pa vlerë, të cilat janë dhunuar këtej e andej. Konkurrimi në sistemin e drejtësisë në shumicën e rasteve ishte fiktiv, pa garë dhe pa numrin minimal në çdo post, duke hequr atë që ishte elementi i konkurrueshmërisë dhe dhënies së një fryme të drejtësisë me njerëz të rinj dhe me mundësi të mëdha e hapësira konkurrimi. Institucionet e rëndësishme, si SPAK-u dhe BKH-ja, filluan funksionimin pa numrin e ligjshëm të anëtarëve të tyre. Sot e kësaj dite Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë janë pa numrin e plotë të funksionimit të tyre, duke kaluar të gjitha afatet kushtetuese të parashikuara në ndryshimet e 21-22 korrikut. Gjatë

plotësimi të procesit të Gjykatës Kushtetuese u vërtetua qartë tentativa mafioze e kryetarit të saj, Dvorani, për të rrëmbyer anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, kompetencë e Presidentit. Dhjetëra ligje të reformës u ndryshuan nga parlamenti monist, pa konsultim me Venecien, në mënyrë të njëanshme dhe si nisma të qeverisë për të plotësuar kapjen.

Asnjë strategji nuk është hartuar për të zgjidhur kolapsin total të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet, ku mungesat në personel janë kritike. Në Gjykatën e Lartë ka 30 e ca mijë çështje dhe mbi 70 mijë të tjera janë në gjykatat e tjera. Vetingu u katandis në një inspektorat të deklarimit të pasurive dhe nuk funksionuan kriteret e tjera, që u konstatuan edhe nga Komiteti i Helsinkit dhe nga organizma të tjerë të pavarur. Institucionet e reja u ngritën në mënyrë skandaloze, duke përbuzur edhe gjetjet e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe duke zgjedhur njerëzit me rekorde shumë të rënda. Gjykata Kushtetuese (i vetmi atribut i qeverisë që të financonte), ka pohuar publikisht që nuk janë vënë në dispozicion as fondet minimale për funksionimin e saj të domosdoshëm, e ashtuquajtura e “kapur” i ka shërbyer vetëm pandëshkueshmërisë, ku çështjet që bubulojnë janë aty, mu në mes, të paprekura, pa përgjegjës, duke filluar që nga “Teatri”, nga çështja “Beketi”, incineratorët, porti i Durrësit, për të mos cituar të tjera. Për sa i përket kapjes së dytë të madhe, pra zgjedhjeve, raporti i OSBE/ODIHR-it ishte i qartë: “Qeveria organizoi shitblerjen mafioze më të madhe që ekziston, qeveria guxoi t’u heqë të drejtën e votës emigrantëve, qeveria shpërdoroi pushtetin dhe përdori në mënyrë kriminale të dhënat personale të qytetarëve, zptoi kriminalisht medien, punësoi mijëra njerëz në mënyrë të paligjshme në administratë dhe shpërdoroi miliona euro të rindërtimit për të orientuar votën, përdori edhe grupet kriminale.” dhe të gjitha këto janë të evidentuara.

Po çfarë ndodh në ekonomi?! Kemi borxhin më të lartë në rajon, që është rritur në mënyrë abuzive nga qeveria, ndërsa borxhi prej qindra milionësh rëndon jetën e qytetarëve, asgjë e mirë nuk ka ndodhur, përkundrazi, shqiptarëve u është bërë ky vend i pajetueshëm, ndaj me qindra e mijëra e braktisin atë. Kush e rriti këtë borxh? Cila është pjesa e padeklaruar? Koncesionet që nuk llogariten; miliona euro të papaguara; qindra milionë euro të humbura në arbitrazhe. Rezultati i jashtëzakonshëm ishte: Shqipëria vendi i dytë për korrupsionin në botë. Shqipëria me borxhin më të madh në rajon. Shqipëria kthim në listën e zezë për pastrim parash. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja: kapja e jetës dhe e shëndetit. Pandemia, një ngjarje tepër e rëndë, u karakterizua nga disa momente, njëri më tragjik sesa tjetri. U provua publikisht, edhe nga të dhënat e fundit tashmë objektive (nuk janë të dhënat e opozitës, megjithëse opozita nuk ka reshtur duke bërë detyrën e saj, profesionalisht shumë më tepër sesa politikisht për pandeminë), se janë fshehur mijëra vdekje, plot 16 mijë, sipas të dhënave, pikërisht, që vijnë nga institucionet europiane. Shqipëria teston 3 herë më pak se Kosova. Testim do të thotë diagnozë, ndan të shëruarin nga i sëmuri. Për financimin, për të cilin ka edhe një shifër të turpshme, që paska qenë 43% në vitin 2013 dhe këta e kanë rritur 77%, ka një rezultat që flet vetë: mbi 150 milionë euro kanë dalë nga xhepat e shqiptarëve për t’u kuruar për pandeminë dhe janë rimbursuar barna as më pak e as më shumë se rreth 200 mijë euro. Diferenca është e frikshme dhe rrënim, borxhi, fatkeqësia në të cilën kanë rënë shqiptarët për shkak të borxhit për të përballuar pandeminë është bërë kritike, është bërë një dramë e re më vete, është një pandemi brenda pandemisë. Për sa i përket infrastrukturës, pra bërëtitjet e tyre për transformim, është i njëjti spital infektiv, i njëjti laborator i shëndetit publik, të gjetur që në momentin kur erdhën në pushtet dhe nuk përfunduat dot asnjë spital, me përjashtim të spitalit fushor në Fier. Masat e ndërmarra ishin tërësisht masa politike dhe jo epidemiologjike, që parathuhet nga ministrja, veçse bekohen nga një Komitet Teknik Ekspertësh, fatkeqësisht “kukull”, jo në shërbim të shkencë, por në shërbim të politikës së Kryeministrit. Pasaporta e vaksinimit Ta sqarojmë për të gjithë opinionin publik, sepse nuk iu kursye mashtrimi. Ajo është e vlefshme, po, por vetëm për ato vaksina të njohura nga institucionet europiane, të gjitha vaksinat e tjera, kineze, ruse, nuk njihen. Pra, edhe ky mashtrim nuk kishte pse të mos u kursehej shqiptarëve. E fundit, do të thosha me gojën plot: kjo pandemi ishte fatkeqësi e madhe që

kishte këtë maxhorancë, këtë “Rilindje” dhe kjo fatkeqësi u ra në kurriz shqiptarëve, vërtet një fatkeqësi shumë e rëndë, por që duhet përmbysur sa më parë. Faleminderit!